

## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE

### ALFA PACK SHPK

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Ortakët**

1.1 Ortakët e Shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- **Z. Orestis Popotas** shtetas grek, lindur në Sofades, Greqi, më 15 Qershor 1959, mbajtës i pasaportës nr. AP1049487, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### **EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

##### **Neni 2 Emërtimi**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Alfa Pack Shpk** (më poshtë e quajtur si “Shoqëria”).

##### **Neni 3 Forma ligjore**

3.1 Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar, por mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjisacionin shqiptar.

##### **Neni 4 Baza ligjore**


4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe legjisacionin shqiptar në fuqi.

##### **Neni 5 Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar kohe.

##### **Neni 6 Selia**

6.1 Selia shoqërisë është në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 5/4, Tiranë, Shqipëri.



6.2 Shoqëria mund të krijojë ose mbajë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të krijojë ose mbyllë seli në adresë të tjera, pavarësisht selisë ligjore në Shqipëri.

### **Neni 7 Simboli/Vula**

7.1 Shoqëria do të ketë simbolin dhe vulën e saj. Administratorët përdorin vulën.

7.2 Forma, modeli dhe masa e vulës duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet kenë simbolin/vulën.

### **Neni 8 Objekti**

8.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë:

Ndërmjetësimi, negociata dhe porosi në nivel ndërkombëtar në industritë ushqimore, farmaceutike, grafike, konvertuese, auto-motore, kimike etj.

Shërbime agjensie, ndërmjetësimi me komisione, shërbime konsulencash dhe shërbime të tjera të rëndësishme për materiale paketimi, plastike, letër, alumin, për lëndë të parë, lëndë të pjesshme, si baza plastike/letër/alumin, letra për përpunim të mëtejshëm, printime etj. Porosi përlëndë të gatshme, si kapakë, tabaka, dhe makineri paketimi.

Zhvillim, shitje, blerje, dhënie me qira e ndërmjetësim të pasurive të paluajtshme.

8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **Neni 9 Kapitali i Shoqërisë**

9.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë dhe është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortakët e Shoqërisë.

9.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, si më poshtë:


- **Z. Orestis Popotas** shtetas grek, lindur në Sofades, Greqi, më 15 Qershor 1959, mbajtës i pasaportës nr. AP1049487, zotëron të gjithë kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej 100 (njëqind) lekë, të cilat përfaqësojnë **100%** të kapitalit të Shoqërisë;

9.3 Përgjegjësia e ortakëve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

### **Neni 10 Transferimi i kuotave**

10.1 Transferimi i kuotës përkatëse ose pjesëve të saj të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, dhurim ose me çdo mënyrë tjeter të parashikuar nga ligji.

Në rast transferimi të kuotës ose pjesëve të saj tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, me shitje, dhurim apo çdo formë tjeter kalimi tek persona të tretë, ortaku që synon të transferojë kuotën përkatëse ose pjesë të saj (Ortaku Transferues) duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Administratorit. Ortakët e tjerë kanë



të drejtën e parablerjes së kuotës ose pjesëve të saj nga Ortaku Transferues proporcionalisht me përqindjen e zotëruar në kapitalin e shoqërisë dhe këta ortakë të tjëri duhet ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të Ortakut Transferues për të transferuar kuotat.

### **Neni 11 Zmadhim kapitali**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet përmes kontributeve në para ose përmes kontributeve në natyrë, përmes përfshirjes në kapital të fondev dhe përfitimeve të pashpërndara, si dhe në çdo formë tjetër të parashikuar nga ligji. Në çdo rast, me nënshkrimin e kontributit në natyrë, duhet të mbahet raporti vlerësues përkatës nga një ekspert i autorizuar.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet kontributit në para mund të realizohet nga ortakët ekzistues me anë të nënshkrimit dhe shlyerjes së kontributeve shtesë në kapitalin e Shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet nga përfshirja e ortakëve të ri dhe kalimit/përfitimit të një kuote të vetme në kapitalin e Shoqërisë me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara dhe shlyera në kapitalin të Shoqërisë.

### **Neni 12 Zvogëlim kapitali**

- 12.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për mbulimin e humbjeve ose në çdo formë tjetër të parashikuar nga dispozitat ligjore dhe ky Statut.

### **Neni 13 Pjesëmarrja, Votimi dhe Përfaqësimi**

- 13.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e ushtrimit të votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Secili prej ortakëve ka të drejtën e një vote në mbledhjen e asamblesë e cila është e barabartë me vlerën e kontributeve të nënshkruara dhe shlyera dhe përllogaritet në proporcion me përqindjen e zotëruar dhe që përfaqëson në kapitalin e Shoqërisë.
- 13.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 13.3 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, telekonferencës, video konferencës apo mjeteve të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të janë identifikuar dhe t'i jepet mundësia për të ndjekur diskutimin dhe komunikimin e ndërsjellë në kohë reale nga një vendndodhje tjetër, duke përdorur masat teknike të nevojshme për sigurinë e mjeteve të komunikimit deri në masën e përdorimit proporcional për arritjen e qëllimeve. Nëse plotësohen dhe zbatohen këto kritere, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllim mbajtjen e procesverbalit përkatës të takimit si dhe nënshkrimin e tij nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes.



## **ORGANET DREJTUESE**

### **Neni 14 Organet e Shoqërisë**

14.1 Organet e Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Administratori/ët.

### **Neni 15 Asambleja e Përgjithshme**

15.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarres i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

15.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

15.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritet tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

15.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjeter të shënuar në njoftimin për mbledhje. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresë të ortakut të Shoqërisë të regjistruar në librat e Shoqërisë ose nëpërmjet postës elektronike (email) të regjistruar në librat e Shoqërisë. Njoftimi me shkresë dhe/ose me postë elektronike dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë ortakëve, 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së parashikuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

15.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që kanë nënshkruar dhe zoterojnë të paktën 5% të kontributeve në kapitalin e Shoqërisë.

15.6 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori ose çdo person tjeter i autorizuar prej tij me shkrim për këtë qëllim është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve. Prosesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të sekretarit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

15.7 Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të zakonshme dhe jashtëzakonshme.

### **Neni 16 Asambleja e Zakonshme**

16.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit finanziar, për miratimin e raportit të administratorëve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

16.2 Vendimet e zakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë dhe që zoterojnë të paktën 51% të kapitalit të Shoqërisë.

16.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 16.2, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

## **Neni 17** **Asambleja e Jashtëzakonshme**

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtëzakonshme sa herë është e nevojshme për martjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.
- 17.2 Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, ndryshimin thelbesor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërisë, konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.
- 17.3 Vendimet e jashtëzakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë dhe që zoterojnë të paktën 80% të kapitalit të Shoqërisë.
- 17.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 17.3, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

## **Neni 18** **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

18.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre sipas ligjit dhe këtij statuti;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- j) shpërndarjen e fitimeve;
- k) riorganzimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë;
- m) çështje të tjera të caktuara nga ligji ose nga ky Statut.

## **Neni 19** **Administratori/ët**

- 19.1 Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person/a fizik/ë, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas këtij Statuti.
- 19.2 Administratori/ët ëmërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.
- 19.3 Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.
- 19.4 Administrator i Shoqërisë është:  
- **Z. Orestis Popotas** shtetas grek, lindur në Sofades, Greqi, më 15 Qershor 1959, mbajtës i pasaportës nr. AP1049487.



**Neni 20**  
**Kompetencat e Administratorit/ëve**

- 20.1 Administratori/ët është/janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson/jnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjt të zbatueshëm.
- 20.2 Administratori/ët ka/në të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjt të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.
- 20.3 Administratori/ët ka/në kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:
- a) mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
  - b) përfaqëson Shoqërinë;
  - c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
  - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore, si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklarim tjetër i detyrueshëm sipas ligjt ose statutit, janë bërë siç duhet;
  - f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të autorizuar dhe i paraqet Asamblesë së Përgjithshme raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
  - g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
  - h) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
  - i) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

**Neni 21**  
**Dividenti**

- 21.1 Shoqëria do ti shpërndaqë ortakëve të saj të gjithë fitimet që mund të arrihen pasi të ketë përbushur të gjitha kërkesat dhe detyrimet në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

**Neni 22**  
**Viti finanziar**

- 22.1 Viti ushtrimor finanziar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**Neni 23**  
**Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit**

- 23.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme dhe duhet të hartohej për tu paraqitur organeve tatimore, deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 23.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhen dhe në monedhën Shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valute.
- 23.3 Shoqëria mund të marre financime nga ortaket, institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për ketë qellim shoqëria mund të japë si garanci barre mbi pjesët e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblesë se Përgjithshme.



**Neni 24**  
**Likuidimi**

- 24.1 Në rast të prishjes së Shoqërisë, Shoqëria likuidohet.
- 24.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë likuidatorë, të cilët do të kenë të gjitha të drejtat dhe detyrat të parashikuara nga ligji i zbatueshëm.
- 24.3 Pas mbledhjes së kredive të prapambetura dhe pagimit të kreditorëve, likuidatori/ët do tja shpërndajnë vlerën/asetat e mbeturë Ortakëve.

**Neni 25**  
**Mosmarrëveshjet**

- 25.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

**Neni 26**  
**Dispozita mbyllëse**

- 26.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i terti dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 26.2 Ku Statut hartohej në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe angleze me fuqi të njëjtë ligjore.

Nënskruar, sot më datë 18.06.2018.

**ORTAKËT**

Z. Orestis POPOTAS



Orestis  
Popotas